



- [Të reja](#) ▾
 [Kush jemi](#) ▾
 [Historiku](#)
[Shërbime](#) ▾
 [Baza ligjore](#)
[Vendndodhjet](#)
[Video](#)
[Programi i transparencës](#) ▾
 [Kontakt](#)
- [Denonco Krimin Kibernetik](#)
[Drejtoritë Vendore](#) ▾
 [Policia Kufitare](#) ▾
 [Policia Rrugore](#) ▾
 [Donacione](#)
[Policimi në Komunitet](#)
- [Përmbledhja Mujore](#)
[Për sinjalizimin](#)
[Të Guximshëm pa Armë](#)

Breaking News: [Kurbini/Finalizohet operacioni policor i koduar "Veprimtaria"](#)



Lajmet Operacionet

14/06/2026

Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Lugina E Errët"

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Lugina e Errët.

Po përgatitej për të kryer një vjedhje banese në Farkë, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 53-vjeçari.

53-vjeçari, me precedent të theksuar kriminal për krime kundër personit dhe pronës.

Sekuestrohen armë zjarri pistoletë, municion luftarak dhe mjete të dyshuara për kryerje vjedhjesh.

Zbardhen edhe 2 raste të tjera vjedhjesh/tentativash për vjedhje banesash, të dyshuara të kryera nga i arrestuari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 1, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e vjedhjes së pronës dhe armëmbajtjes pa leje, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar "Lugina e Errët".

Si rezultat i operacionit u bë i mundur identifikimi, kapja në flagrancë dhe arrestimi i shtetasit A. K., 53 vjeç, banues në Durrës i cili po përgatitej të hynte për të vjedhur në banesën e një shtetasi. Ai u lokalizua dhe u kap në flagrancë nga shërbimet e Policisë.

Gjatë kontrollit iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një armë zjarri pistoletë me një krehër me municion, dy kaçavida, një palë pinca, dy kapele, një maskë e zezë, një palë doreza dhe një shumë parash.

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se 53-vjeçari dyshohet të jetë autor edhe i dy rasteve të tjera të vjedhjes/tentativës për vjedhje banesash, po në zonën e Farkës. Konkretisht, më datë 31.05.2026 dyshohet se ka vjedhur një shumë parash në banesën e shtetasit A. S., ndërsa më datë 05.06.2026 dyshohet se ka tentuar të vjedhë në banesën e shtetasit K. B.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.



Kërko



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ [Vlorë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Metodat"](#)

[Kurbini/Finalizohet operacioni policor i koduar "Veprimtaria"](#) ▶